

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	08.02.21		
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vicra
01	060/03	4553	

PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)

Komuna / Opština: Drenas Data / Datum: 05.02.2020

Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 1

Takim i rregullt / Redovni sastanak ☒

Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak ☐

Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 15

A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së?
 Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?

Po / Da ☐

Jo / Ne ☐

Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☐

A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së?
 Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?

Po / Da ☒

KFOR-LMT K9

Jo / Ne ☐

Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë
 Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju

A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari?
 Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?

Po / Da ☒

Jo / Ne ☐

Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:

Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur me 17.12.2020, Linku: <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2020/12/Procesverbali-i-mbledhjes-se-KKSBB-17.12.2020.pdf>
2. Draft plani i punës së KKSBB-së për punën e vitit 2021;
3. Draft orari i punës së KKSBB-së për vitin 2021;
4. Njoftim lidhur me menaxhimin e vërshimeve të fundit;
5. Përgatitjet nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve – KKZ – Drenas, për zgjedhjet parlamentare;
6. Informim lidhur me fillimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2020/2021;
7. Të ndryshme.

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

1. Qentë endacakë

2. Funkcionalizimi i kamerave në Komoran dhe vendosja e kamerave në Komoran 3

Konkluzionet / Zaključci:

Procesverbali i mbledhjes së fundit u miratua unanimisht dhe pa ndonjë vërejtje. U miratua edhe plani i punës së KKS-së për punën e vitit 2021 si dhe draft plani i punës së KKS-së për punën e vitit 2021.

Për pikën e katërt, drejtoresha e Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapë, i njoftoi të pranishmit për masat e marra nga kjo drejtori dhe për evidentimin e dëmeve të shkaktuara në ekonomitë familjare, në bujqësi dhe në biznese dhe hartimin e raportit përfundimtar në të cilin janë evidentuar të gjitha dëmet e shkaktuara. Raporti është dërguar në ministrinë përkatëse me qëllim të kompensimit eventual nga fondi i caktuar për këtë çështje. Drejtoresha Krapë njoftoi edhe për ndërhyrjet e realizuar nga kjo drejtori pas vërsimeve dhe për bashkëpunimin e mirë me FSK-në dhe AME-në për evitimin e rrezikut të përgjithshëm. Pjesëmarrësit rekomanduan një mbikëqyrje dhe kontroll më të mirë të projekteve të cilat realizohen në komunën tonë me qëllim që në të ardhmen të mos ketë pasoja të mëdha nga vërshimet.

Për pikën e pestë, kryesuesi i KKZ-së në Drenas, Burim Jonuzi, tha se KKZ në Drenas ka përfunduar shumicën e përgatitjeve të nevojshme dhe për pastrimin e listave të votuesve nga KQZ. Gjithashtu tha se subjektet politike janë informuar në lidhje me rregullat që duhet respektuar për një mbarëvajtje të procesit zgjedhor. Jonuzi u përgjigj shumë pyetjeve që kishin të bëjnë me votimin e personave të izoluar dhe të atyre që fizikisht nuk mund të marrin pjesë në votim si dhe për masat shtesë për mbrojtje nga pandemia gjatë procesit zgjedhor.

Për pikën e gjashtë, drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim, Muhamet Gjoka, tha se gjysmëvjetori i dytë ka filluar me skenarin A dhe se shkollat janë të pajisura me material higjienik e dezinfektantë. Ndër të tjerash tha se u ka kërkuar përgjegjësve në shkolla se në objektet shkollore në të cilat mbahen fushatat elektorale duhet të dezinfektohen çdo herë përveç dezinfektimeve të rregullta.

Për të ndryshme, u diskutuan kërkesat e KLSP Komoran për vendosje të pengesave në rrugë pranë QMF-së, si dhe funksionimin e kamerave po në Komoran, dhe për çështje tjera të ngritura nga pjesëmarrësit në lidhje me qentë endacakë, si dhe vendosja e kamerave në lokacione me interes për qytetarë, etj. U konkludua se kamerat në Komoran janë funksionale dhe se as Policia e as DShPE nuk kanë informacion se kamerat janë jashtë funksionit. Ndërsa për pengesat në rrugë do të shqyrtohen mundësitë për vendosjen e tyre pas përfundimit të procedurave tenderuese, gjithmonë në përputhje me ligjin përkatës i cili rregullon këto çështje.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKS-së:

Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Arben Shala

(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)

Procesverbali aprovet nga Kryetari:

Izveštaj odobrava Gradonačelnik: Ramiz Lladrocy

Nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobranja: 08.02.2020

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKS-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKS-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas
Zyra e Kryetarit



Data: 28.01.2021

ORARI I PUNËS SË KKSBS-së – 2021

Me qëllim të realizimit të detyrave operative lidhur me çështjet e sigurisë në bashkësi, në mbështetje të nenit 7 të Ligjit nr. 04/1-076, për policinë, nenit 11, pika 2 e Udhëzimit administrativ nr. 27/2012 MPB-03/2012 MAPL për KKSBS-së, *propozojmë që në vazhdimësi të punohet sipas këtij orari (për periudhën janar — dhjetor 2021).*

<i>Nr. rend</i>	<i>Data e mbajtjes së takimit</i>	<i>Dita dhe ora</i>	<i>Vërejtje</i>
1	05 shkurt 2021	E premte, ora 14:00	Mbledhje e rregullt
2	14 prill 2021	E mërkurë, ora 14:00	Mbledhje e rregullt
3	24 qershor 2021	E enjte, ora 14:00	Mbledhje e rregullt
4	24 gusht 2021	E martë, ora 14:00	Mbledhje e rregullt
5	14 tetor 2021	E enjte, ora 14:00	Mbledhje e rregullt
6	22 dhjetor 2021	E mërkurë, ora 14:00	Mbledhje e rregullt

Shënim: Ky orar mund të ndryshojë në varësi të agjendës dhe angazhimeve të kryesuesit të KKSBS-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas
Zyra e Kryetarit



PLANI I PUNËS PËR VITIN 2021
KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB) -DRENAS

Aktiviteti	Objektivat	Periudha kohore	Rezultati	Përgjegjës
1. Takimet e rregullta mujore të KKSB-së	Prezantimi i punës mujore të KKSB-së	Gjashtëmujori i parë	Funksionalizimi i KKSB-së	KKSB
2. Raportimi gjashtëmujor	Publikimi i punës së KKSB-së	Pas përfundimit të takimeve	Funksionalizimi i KKSB-së	KKSB
3. Komunikata dhe emisione ne Radio dhe TV	Publikimi i punës së KKSB-së për publik më të gjerë	Sipas nevojës	Promovimi dhe funksionalizimi i KKSB-së	Anëtarët e KKSB-së
4. Përgatitja e projekteve në bazë të problemeve të identifikuar nga anëtarët e KKSB-së gjatë vitit 2021	Prezantimi i ideve për mundësitë e zgjidhjes së këtyre problemeve në fushat: 1. Siguria Fizike a) Përdorimi i armëve (dasmat); b) Shkolla (dukuritë negative, çështje tjera të sigurisë etj.); c) Qentë endacakë; d) Lypësit e rrugës; e) Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike, (bashkëpunim me FSK-së dhe DKA-së); f) Ndriçimi publik; g) Statistikat e përgjithshme të krimeve; h) Rrjetet elektrike dhe trafot; i) Identifikimi i rrezeve të mundshme. 2. Siguria e Ambientit a) Deponitë e mbeturinave; b) Ekspozimi i mallrave në ambiente të hapura; c) Zjarret fushore dhe malore - parandalimi i tyre; d) Dezinfectimi, dezinfektimi, deratizimi etj. 3. Siguria Shëndetësore a) Përdorimi nga të rinjtë i narkotikeve dhe cigareve dhe shitja e tyre pranë shkollave –parandalimi; b) Ri-integrimi i personave të riatdhesuar; c) Furnizimi me ujë të pijes.	Janar – Dhjetor	Hartimi i nga një projekti për secilën fushë të identifikuar	Anëtarët e KKSB-së



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas
Zyra e Kryetarit



	4. Siguria Rrugore a) Mbulimi i pusetave; b) Shenjat në rrugë; c) Vijat e bardha (zebrat); d) Renovimi i pjesëve të rrugëve ku ka dëmtime-parandalimi i dëmtimeve; e) Zgjerimi i rrugëve sipas standardeve (Zgjedhja e kontesteve pronësore); f) Largimi i “policëve” të shtrirë ilegalë. 5. Siguria Institucionale a) Vendosja e kamerave; b) Shkallët emergjente nëpër ndërtesa; c) Funksionimi i gjykatës; d) Qendra për Alarmim etj. 6. Propozime tjera Përveç temave të mësipërme Kryetari i Komunës dhe anëtarët e KKS-së mund të propozojnë tema tjera me interes për sigurinë publike në Komunën e Drenasit. Gjithashtu anëtarët e KKS-së mund të diskutojnë dhe të japin ide për projekte infrastrukturore dhe shërbime të cilat ndikojnë në sigurinë publike.			
5. Analizimi i punës së KKS-së për gjashtë mujorin e dytë.	Për të prezantuar problemet e identifikuara dhe mundësia për të propozuar prioritetet tjera për të plotësuar planin e aktiviteteve të KKS-së.	Janar - Dhjetor	Promovimi dhe Funksionalizimi i KKS-së	Anëtarët e KKS-së
6. Debate publike (2)	Prezantimi i të arriturave dhe sukseseve të KKS-së në publik	Janar - Dhjetor	Promovimi dhe publikimi i dy raporteve gjashtë mujore	Anëtarët e KKS-së
7. Vlerësimi i punës së KKS-së.	Vlerësimi i punës nga anëtarët e KKS-së dhe diskutime për të ardhmen e këtij Këshilli.	Para datës 15 dhjetor të vitit 2021	Përgatitja e aktiviteteve për vitin e ardhshëm, mundësia e plotësimit të planit të punës etj.	Anëtarët e KKS-së



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci
Ramiz Lladrovci

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		29/01 2021	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/03	4553	



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas
Zyra e Kryetarit



Data: 28.01.2021

Në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, përkatësisht nenit 9, pika 1.3, dhe Vendimit nr. 12-030-786, të datës 04.01.2018, të Kuvendit Komunal, thirret mbledhja e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBS), dhe në emër të Kryetarit të Komunës, Ramiz Lladrovci, ju drejtojmë këtë:

F T E S Ë


Për anëtarin/en _____, nga _____ që të marrë pjesë në mbledhjen e rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBS), lidhur me zhvillimet në Komunën e Drenasit.

Mbledhja e rregullt do të mbahet më datën 05.02.2021, ditë e premte, me fillim në orën 14:00, në Sallën e Kuvendit në Drenas.

Rendi i ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBS-së të mbajtur me 17.12.2020
2. Draft plani i punës së KKSBS-së për punën e vitit 2021;
3. Draft orari i punës së KKSBS-së për vitin 2021;
4. Njoftim lidhur me menaxhimin e vërsimeve të fundit;
5. Përgatitjet nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve - KKZ – Drenas, për zgjedhjet parlamentare;
6. Informim lidhur me fillimin e gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2020/2021;
7. Të ndryshme.

Kopje: Anëtarëve të KKSBS-së


Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci